



FAQ PYETJE TË SHPESHTA

2022

 +355 44 537390

 info@abinvest.al

 Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27,
Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri

www.abinvest.al



- **Çfarë janë fondet e investimeve?**

Fondi i Investimeve është një strukturë përbashkët e investimit të fondeve të klientëve. Fondi administrohet nga një shoqëri administruese. Praktikisht, fondet e klientëve grumbullohen me qëllim që të investohen në letra me vlerë.

Nëpërmjet përfshirjes në fond investimi, investitorët autorizojnë shoqërinë administruese për ndërtimin të portofolit. Në këtë mënyrë Investitorët marrin një produkt të gatshëm dhe të mirë-diversifikuar.

- **Çfarë është shoqëria administruese?**

Shoqëria administruese është një shoqëri e cila menaxhon fondet e investimit.

Fondet nuk janë në pronësi të shoqërisë administruese, por janë në pronësi të vetë investitorëve të fondit. Detyra kryesore e shoqërisë është të mirë-menaxhojë fondet e mbledhura nga investitorët në interesin më të mirë të tyre.

- **Ku investon një fond?**

Çdo fond investimi investon në tituj të cilët janë parashikuar në Prospekt si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Konkretisht fondet nën administrim të ABI Invest janë të investuar në:

1. ABI EIA – 100% në letra me vlerë të qeverisë së republikës së Shqipërisë
2. ABI Flex EURO & USD - Fondet në EUR dhe USD janë të investuar kryesisht në obligacione qeveritare dhe korporative. Gjithashtu në aksione të korporatave prestigjioze e të mirë-konsoliduara.

- **Ka maturitet një fond investimi?**

Ndryshe nga produktet bankare si depozitat me afat apo dhe letrat me vlerë të borxhit, fondet e investimit nuk kanë maturitet. Përfitueshmëria e investimit në të tillë instrument, varet vetëm nga luhatja e vlerës së çmimit të kuotës gjatë investimit.

Siç specifikohet edhe në dokumentin kryesor për investitorin, shoqëria administruese orienton investitorët që të marrin parasysh një horizont të caktuar investimi për secilin fond që ka nën administrim. Konkretisht, 2 vite për fondin në LEK dhe 10 vite për fondet në EUR dhe USD.

- **Çfarë duhet të bëj për tu bërë pjesë e fondit?**

1. Fillimisht duhet të njiheni me dokumentin themeltar të fondit, i cili quhet Prospekt për tu informuar plotësisht.

Në këtë dokument përshkruhen qartë strategjinë, risqet, objektivat dhe çdo gjë tjetër për të plotësuar kornizën e nevojshme të informacionit lidhur me vetë fondin. Ky dokument mund t'ju vihet në dispozicion ose në të gjitha degët e ABI Bank, ose nëpërmjet website të ABI Invest www.abinvest.al. Përvec Prospektit, shoqëria publikon edhe një dokument i cili quhet "Dokumenti kryesor për Investitorin" i cili është një format relativisht i shkurtër prej maksimumi 2 faqesh ku përmbledhen detaje dhe karakteristika të fondit (si p.sh. niveli i riskut, tarifat, objektivat, risqet, kategoritë e aktiveve etj.

2. Pasi të keni marrë informacion lidhur me pikën nr. 1 dhe të keni marrë vendim për të hyrë në fond, mund të drejtoheni pranë çdo degë të ABI Bank në mënyrë që të kryeni procedurën e blerjes së kuotave.

- **Si mund të blej kuota të fondit të investimit?**

Duke u paraqitur pranë sporteleve të rrjetit të degëve të ABI Bank ju lind mundësia për të aplikuar për të blerë kuota të fondit. Shërbimi i klientit, në rolin e personelit të autorizuar për shitje të fondit të investimit, do t'ju udhëzojë në lidhje me procesin dhe dokumentet e nevojshme për blerjen e kuotave.

- **Mund të blej kuota në çdo shumë?**

Ju mund të blini kuota të fondeve të investimit në shumat si më poshtë:

1. ABI EIA (fondi në LEK)

Aplikimi fillestar minimum LEK 100,000. Shtesa në fond minimumi LEK 10,000

2. ABI Flex EURO (fondi në EURO)

Aplikimi fillestar EUR 500. Shtesa në fond minimumi EUR 100.

3. ABI Flex USD (fondi në USD)

Aplikimi fillestar USD 500. Shtesa në fond minimumi USD 100.

- **Pas blerjes së kuotave, si mund të ndjek ecurinë e fondit?**

Pas blerjes së kuotave, ju do të pajiseni me kredencialet e nevojshme (username dhe password) në mënyrë që të aksesoni një sistem i cili do t'ju bëjë të mundur të kontrolloni në çdo kohë vlerën e investimit tuaj. Ky portal gjendet në faqen kryesore të linkut www.abinvest.al

Kujdes: Menjëherë pas marrjes së kredencialeve, duhet të ndryshoni fjalëkalimin.



- **Çfarë duhet të bëj nëse harroj fjalëkalimin?**

Nëse harroni fjalëkalimin, mund të pajiseni me një fjalëkalim të ri, në çdo kohë duke na kontaktuar në një prej degëve të ABI Bank.

- **A mund të kontrolloj ecurinë e fondit, pa qenë akoma pjesë e tij?**

Ju mund të gjeni në çdo kohë informacion për ecurinë ditore të fondit në website të shoqërisë <https://www.abinvest.al/c/2/fondet-e-investimit>.

Shoqëria ka detyrim të publikojë çdo ditë këtë informacion.



Rreth Nesh

Fondet e Investimit

Kuadri Ligjor

Publikime



Eng

Fondet e Investimit

Home > Fondet e investimit > Të dhënat e fondeve të investimeve

Të Dhënat e Fondeve të Investimeve

Fondet e Investimit

Të Dhënat e Fondeve të Investimeve

Dokumentacioni i Fondeve të Investimeve

Raporte të Fondeve të Investimeve

Si të Investoj?

Të Dhënat e ABI EIA



Të Dhënat e ABI FLEX EURO



Të Dhënat e ABI FLEX USD



- **Sa shpejt mund të shes kuotat e fondit?**

Ju mund të kërkonti të shisni në çdo moment kuotat që keni në pronësi, duke u paraqitur në çdo degë të rrjetit të ABI Bank. Shoqëria ka detyrim ligjor të kalojë në llogarinë tuaj vlerën përkatëse brenda 7 ditëve pune nga dita e depozitimit nga ana juaj të kërkesës për shitje të kuotave të fondit.

Çmimi i daljes, në çdo rast do të jetë ai i datës së depozitimit nga ana juaj të kërkesës për dalje nga fondi.

- **A mund të bëj shitje të pjesshme të kuotave?**

Ju mund të bëni shitje të plotë ose të pjesshme të kuotave të fondit.

- **Çfarë ndodh me pjesën e mbetur të investimit, nëse unë bëj dalje të pjesshme nga fondi?**

Nëse kryeni dalje të pjesshme, pjesa e mbetur në fond vijon të mbetet e investuar dhe e vlerësuar çdo ditë nëpërmjet cmimeve të publikuara.

- **Si taksohem për fitimet e realizuara?**

Në bazë të legjislacionit shqiptar për tatimin e mbajtur në burim, ju taksoheni vetëm për pjesën e fitimit të realizuar nga investimi.

Shembull:

Në datë 1 Dhjetor 2021 keni blerë 100 kuota më vlerën LEK 1,000 secila dhe vlera totale e investimit është 100 kuota*LEK 1,000 për kuotë=LEK 100,000.

Në datën 1 Mars 2023 i shisni të gjitha kuotat me cmimin LEK 1,100 për kuotë. Vlera e investimit në datën 1 Mars 2023 është 100 kuota*LEK 1,100 për kuotë=LEK 110,000

Fitimi i realizuar është vlera e investimit në datën 1 Mars 2023 LEK 110,000-vlerën e investimit fillestar me datë 1 Dhjetor 2021 LEK 100,000=LEK 10,000.

Sikurse sot, % e tatimit në burim sipas legjislacionit shqiptar është 15%. Tatimi që mbahet është Fitimi i realizuar LEK 10,000*15%=LEK 1,500. Fitimi neto i realizuar nga investimi është LEK 8,500.

Kujdes: Vlerat e mësipërme kanë vetëm karakter shpjegues dhe ilustrues. Ecuria e kuotave të fondit varet vetëm nga tregu dhe çdo fitim i fondit nuk mund të garantohet.

- **Si mund të kontaktoj direkt me shoqërinë e Fondit, nëse kam pyetje?**

Ju mund të kontaktoni nëpërmjet rrjetit të degëve të ABI Bank, nëpërmjet adresës së email info@abinvest.al ose nëpërmjet numrave të telefonit të cilët janë shpallur në www.abinvest.al